



12-12-2017



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337 kqz.sekretarati@kqz-ks.org www.kqz-ks.org

Prishtinë / Priština
Nr./Br. 2562-2017

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 12.12.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.SHEFIK SURDULLI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Gjilan, nga subjekti politik "PDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **z.Illir Tahirin**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet **z.Shefik Surdulli**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dozuara në KQZ më datën 11.12.2017, nr.2528/2017, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z.Illir Tahiri, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është z.Shefik Surdulli, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 12.12.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

